

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/90500-26-4706-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me makinë industriale për larjen e enëve-Ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	E-COMPANY SH.P.K.
NUI	810734245
Adresa	Xhelal Hajda - Toni
Vendi	Rahovec
Kodi postar	21000
Numri Telefonit	+38349444377
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ardian Osa
Adresa elektronike	ecompanyntp@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	04.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me makinë industriale për larjen e enëve-Ritender

Furnizim me makinë industriale për larjen e enëve - RITENDER

B05 Njoftim për Kontratë publikuar ne e-prokurim me datë 16.06.2026

Kërka per rishqyrtim eshte dorzuar me date 27.06.2026 në ora 08:49

Vendimi për pezullim pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, është publikuar me 29.06.2026 në ora 11:14

Vendimi në kërkes për rishqyrtim është publikuar me date 30.06.2026 ora 13:26

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 27.06.2026 kemi dorzuar kërkesë për rishqyrtim dhe me datën 29.06.2026 AK e ka refuzuar kërkesën tone duke e hedhur si të jashtëafateshme.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim Autoriteti kontraktues ka shkelur dispozitat si më poshtë:

Neni 5 i LPP- Kalkulimi i afateve kohore
Neni 108/A i LPP - Zgjidhja preliminare e mosmarreshjeve
Neni 60 i Rregullores Nr 002/2024 për Prokurim Publik

Ndërsa sa i përket pretendimeve tona në kërkesë për rishqyrtim lidhure me Njoftimin për kontratë janë:

Neni 1 Qëllimi
Neni 2 Fushëveprimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 29 Variantet e specifikimeve teknike
Neni 32 Rregullat e Përgjithshme
Neni 17.17 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022 (Plotesuar dhe ndryshuar me rregulloren Nr. 002/2024) - Dosja e tenderit nuk duhet të kufizojë konkurrencën ose të diskriminojë OE-të;
Neni 17.22.1 të RRPP - Kërkesat obligative për specifikimet teknike të furnizimeve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim Autoriteti kontraktues ka shkelur dispozitat si më poshtë:

Argumenti I

Autoriteti Kontraktues ka aplikuar gabimisht formulën e vet të kalkulimit (Shkelje e nenit 60.1(a) të Rregullores dhe nenit 108/A.3.1 të LPP-së)

Vetë AK-ja, në faqet 2 dhe 3 të vendimit të kundërshtuar, citon fjalë për fjalë Interpretimin Ligjor Nr. 35 të KRPP-së (04.12.2023), i cili shpjegon metodologjinë e kalkulimit retroaktiv të afatit prej pesë (5) ditësh para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave, duke dhënë si shembull: nëse afati i dorëzimit të

ofertave është 15.11.2023 (dita "0"), ditët e bllokuara janë 14, 13, 12, 11 dhe 10 nëntor, dhe dita e fundit kur mund të dorëzohet kërkesa për rishqyrtim është

09.11.2023, para orës 16:00.

Duke zbatuar saktësisht të njëjtën metodologji të cituar nga vetë AK-ja mbi datat konkrete të këtij rasti (afati i dorëzimit të ofertave:

06.07.2026), rezultati

është si vijon:

Data: 27.06.2026, e shtunë, Dita kurë është dorëzuar kërkesa për rishqyrtim

Data: 28.06.2026, e diel, Dita "-8"

Data: 29.06.2026, e hënë, Dita "-7"

Data: 30.06.2026, e martë, Dita "-6" Dita e fundit ligjore për dorëzim (para orës 16:00)

Data: 01.07.2026, e mërkurë, Dita "-5"

Data: 02.07.2026, e enjte, Dita "-4"

Data: 03.07.2026, e premte, Dita "-3"

Data: 04.07.2026, e shtunë, Dita "-2"

Data: 05.07.2026, e diel, Dita "-1"

Data: 06.07.2026, e hënë, Dita "0" Afati i fundit për dorëzim të ofertave

Nga u tha më lart shihet qartë se dita e fundit ligjore për dorëzimin e Kërkesës për Rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë ishte data

30.06.2026, para orës

16:00. Operatori Ekonomik E-COMPANY SH.P.K. e ka dorëzuar kërkesën më datë 27.06.2026, pra tri (3) ditë para skadimit të këtij afati.

Rrjedhimisht, kërkesa për rishqyrtim ka qenë e dorëzuar brenda afatit ligjor prej pesë (5) ditësh të parapara me nenin 60.1(a) të Rregullores dhe nenin 108/A paragrafi

3.1 të LPP-së, dhe jo "jashtë afatit" siç ka konstatuar AK-ja.

Konstatimi i AK-së për jashtëfatshmëri të kërkesës bie ndesh me faktet e veta të pranuar në

vendim (data e njoftimit, 15.06.2026, dhe data e afatit të dorëzimit të ofertave, 06.07.2026) dhe me formulën e vet të kalkulimit të cituar në po të njëjtin vendim.

Meqenëse kushti faktik i parashikuar në nenin 108/A paragrafi 8.1 të LPP-së (mosdorëzimi brenda afatit të paragrafit 3) nuk është plotësuar, refuzimi i kërkesës mbi

këtë bazë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 108/A dhe të nenit 60 të Rregullores.

Argumenti II Shkelje e nenit 5 të LPP-së në kalkulimin e afatit

Sipas nenit 5 paragrafi 2 të LPP-së, të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare llogariten në

kalkulimin e afateve kohore; përjashtim bën vetëm rasti kur vetë dita e fundit e afatit bie në

fundjavë ose festë zyrtare, rast në të cilin afati zgjatet deri në ditën e parë të punës. Në rastin konkret:

- Dita e fundit e afatit për dorëzimin e kërkesës (30.06.2026) bie të martën "ditë pune" andaj nuk aplikohet asnjë zgjatje; afati mbetet 30.06.2026, para orës 16:00.

- Fakti që kërkesa është dorëzuar të shtunën (27.06.2026) nuk e bën atë të parakohshme apo të vonuar;

neni 5 nuk kërkon që vetë dita e dorëzimit të kërkesës të jetë ditë pune, përderisa kërkesa dorëzohet përmes sistemit elektronik brenda afatit; kërkesa për "ditë pune" lidhet me fillimin/mbarimin e vetë afatit (dhe me orarin deri në 16:00), jo me çdo datë individuale brenda periudhës.

Nëse arsyetimi i AK-së bazohet siç sugjeron referenca e pashpjegueshme të neni 42.7 i Rregullores (dispozitë që rregullon afatin për ankesa kundër njoftimit mbi vendimin B58, jo kundër njoftimit të kontratës B05) në një numërim "Përpara" nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë (15.06.2026) në vend të numërimit "prapa" nga afati i dorëzimit të ofertave (06.07.2026), atëherë AK-ja ka aplikuar metodologjinë e gabuar të kalkulimit të parashikuar për një kategori tjetër ankesash (ato kundër vendimeve për dhënie kontrate, neni 60.1(b), apo kundër anulimit, neni 60.1(c)), duke shkelur kështu vetë parimin e nenit 5 të LPP-së për kalkulimin e saktë të afateve, sipas dispozitës përkatëse që rregullon rastin konkret (neni 60.1(a)).

Argumenti III Konfuzion mes dispozitave dhe mungesë arsyetimi i mjaftueshëm **shkelje e nenit 108/A paragrafi 9 i LPP-së)**

Neni 108/A paragrafi 9 i LPP-së kërkon shprehimisht që çdo refuzim i kërkesës për rishqyrtim "do të arsyetohet". Vendimi i kundërshtuar citon saktë shembullin numerik të Interpretimit Nr. 35 të KRPP-së, por nuk e riprodhon të njëjtin kalkulim mbi datat aktuale të rastit në vend të kësaj, kalon direkt te konstatimi konkluziv se kërkesa është "e jashtëfatshme", pa e demonstruar në mënyrë transparente se si arrihet në atë përfundim nga datat 15.06.2026 (njoftimi), 06.07.2026 (afati i ofertave) dhe 27.06.2026 (dorëzimi i kërkesës).

Për më tepër, citimi i nenit 42.7 të Rregullores "dispozitë që rregullon shprehimisht afatin e ankimit kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58) dhe jo kundër Njoftimit për Kontratë (B05)" tregon se AK-ja ka përzier dy rregulla të ndryshme kalkulimi (njërin retroaktiv, nga afati i ofertave; tjetrin prospektiv, nga data e njoftimit të vendimit), duke prodhuar kështu një arsyetim të brendshëm kontradiktor dhe jo në përputhje me kërkesën për arsyetim të bazuar në ligj, siç e kërkon neni 108/A paragrafi 9 i LPP-së.

Nga sa u parashtrua më lart, rezulton se:

- Kërkesa për Rishqyrtim e dorëzuar nga E-COMPANY SH.P.K. më datë 27.06.2026 ka qenë brenda afatit ligjor prej pesë (5) ditësh të paraparë me nenin 60.1(a) të Rregullores Nr. 002/2024 dhe nenin 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së, pasi dita e fundit ligjore për dorëzim ka qenë 30.06.2026.

- Konstatimi i AK-së për jashtëfatshmëri të kërkesës bazohet në një zbatim të gabuar (ose të mospërfunduar/të pashpjeguar)

të formulës së vet të kalkulimit, në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 108/A të LPP-së, si dhe me nenin 60 të Rregullores.

- Vendimi vuan gjithashtu nga mungesa e arsytimit të mjaftueshëm dhe konsistent, në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 9 të LPP-së, për shkak të përzierjes së dispozitave (neni 60.1(a) kundrejt nenit 42.7/60.1(b)).

Ndërsa sa i përket pretendimeve tona ne kërkes për rishqyrtim lidhure me Njoftimin për kontrate janë:

Parashtruesi i kësaj ankese është operator ekonomik i regjistruar, aktiv në fushën e furnizimit me pajisje industriale, dhe si i tillë ka interes të drejtpërdrejtë dhe legjitim për të marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi. Parashtruesi kualifikohet si "palë e interesuar" sipas nenit 4, paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP).

BAZA LIGJORE

Kjo kërkesë për rishqyrtim parashtrohet në mbështetje të Nenit 109 të LPP (Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092) Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve;

Bazuar në faktet që do të paraqiten në këtë kërkesë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të parapara me LPP dhe Rregullorevëne fuqi që mbulojnë prokurimin publike.

Në vazhdim do të shpalosim të gjitha faktet dhe argumentet që mbështesin këtë kërkesë tona.

PIKA 1. Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 2 Operatori ekonomik duhet të ofroj autorizimin nga prodhuesi për të gjithë artikujt e përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Dëshmia 2 Autorizimin nga prodhuesi. Autorizimi përveç tjerash duhet të përfshijë modelin e pajisjes, kodet përkatëse të artikujve dhe numrin e prokurimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Autorizimi duhet të jetë valid I skanuar nga Origjinali (nëpërmes e-prokurimit në formë elektronike).

- Me anë të kësaj kërkesë specifike AK ndikone drejtpërdrejt në rezultatin e këtij aktiviteti të prokurimit respektivisht kompanin ciles do të jepet kjo kontrate. Kjo kërkesë është diskriminuese për

aprovoj në tërësi si të bazuar, duke marrë:

V E N D I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e OE E-COMPANY SHPK lidhur me pretendimet lidhur me shkeljet e AK ne vendim per hedhjen si te jashtafatshme te kerkeses sone per rishqyrtim

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e OE E-COMPANY SHPK lidhur me pretendimetsa i perket lidhure me Njoftimin per kontrate jane.

ANULOHET vendimi i AK për hedhje si të jashtëafatshëm të kërkeses për rishqyrtim. ANULOHET njoftimi per kontrate i AK, Te urdherohet AK qe te beje korrigjimet e duhura bazuar ne LPPsë

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme për përpilimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit në AK në përgatitjen e dokumentacionit të ankesës ne OSHP dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit ashtu edhe në fitimin e humbur si pasojë direkte e vlerësimit diskriminues në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akteve tjera nënligjore ,dhe interpretimin e neneve përkatëse nga ana e ekspertëve të KRPP-së.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*